



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 32/18
Prishtinë, më 26.09.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Blerim Kuqi, Fikrim Damka, Enver Hoti dhe Dardan Molliqaj.

Mungoi: Lumir Abdixhiku.

Pjesëmarrës tjerë: Edita Ferati – Praktikante nga KDI, Fixhirje Dragaj – Këshilltare e Grupit Parlamentar të AAK, Shpresë Sejdi - Asistente e Grupit Parlamentar të PSD, Dren Ajeti - Klubi i Prodhuesve, Arta Dehari – Asistente e Grupit Parlamentar të LVV, Vatra Qehaja – Këshilltare e Grupit Parlamentar të LVV, Nora Kokaj nga Ambasada Britanike, Valbona Bytyçi – Gazetare nga Ekonomia Online, Albulena Avdiu – Gazetare nga Ekonomia Sot dhe Albulena Mavraj – Gazetare.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Zëvendëskryetarja e parë e komisionit – Safete Hadërgjonaj.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;**
- 4. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Safete Hadërgjonaj: Konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Safete Hadërgjonaj: Theksoi se në bazë të nenit 4 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 2.1. të Ligjit Nr. 05/L-116 , Komisioni për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në përbërje nga: Fehmi Mehmeti – Guvernator i BQK-së (kryesues i komisionit), Bedri Hamza - Ministër i Financave (anëtarë i komisionit) dhe Besnik Omani. Auditor i Përgjithshëm (anëtar i komisionit), ka hapur konkursin, ka bërë intervistimin e kandidatëve, aplikacionet e të cilëve janë konsideruar si më relevante nga komisioni dhe që kanë plotësuar kriteret formale.

Komisioni për Përzgjedhje në pajtim me nenin 4, paragrafi 10 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, ka bërë verifikimin e përshtatshmërisë së kandidatëve, i cili ka rezultuar se asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk ka pengesë sipas këtij kriteri.

Si rrjedhojë në pajtim me nenin 4, paragrafi 5, paragrafi 6 dhe paragrafi 11 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Komisioni për Përzgjedhje, i ka propozuar Kuvendit, që të emërojë 5 kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit Pensional, prej të cilëve njëri është propozuar si Kryesues dhe një tjetër në cilësinë e anëtarit për përfaqësimin dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë, dhe ata janë: Ruzhdi Morina (është propozuar për kryesues të Bordit Drejtues të FKPK-së), Frederick Artesani, Behxhet Haliti, Driton Qehaja, dhe Ymer Ymeri (për përfaqësimin dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë).

Qeveria brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nuk i ka dërguar Kuvendit ndonjë mendim për kandidatët e propozuar.

Nga të dhënat e paraqitura në CV, kuptojmë se kandidatët e propozuar për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit Pensional, i plotësojnë kushtet dhe kriteret e domosdoshme parapara me nenin 4.3., 4.4. dhe 4.5. të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, ku parashihet që personat që emërohen për anëtarë të Bordit Drejtues, duhe të jenë posedojnë aftësi dhe përvojë profesionale në çështjet e pensionit, financiare, të investimeve dhe të sigurimit. Si dhe përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë. Po ashtu, Komisioni për Përzgjedhje ka vlerësuar se kandidatëve të propozuar, nuk kanë ndonjë pengesë ligjore, që do të binte ndesh me nenin 4.9. dhe 4.12. të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, zëvendëskryetarja e parë, konstatoi se komisioni me Pesë vota Për, tri Kundër dhe Një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit, të emërojë kandidatët e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje, për kryesues dhe anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, si në vijim:
 1. **Ruzhdi Morina**, kryesues
 2. **Behxhet Haliti**, anëtar
 3. **Driton Qehaja**, anëtar
 4. **Frederick Artesani**, anëtar
 5. **Ymer Ymeri**, anëtar për përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre.
2. Mandati i kryesuesit dhe anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është katërvjeçar, në pajtim me nenin 4, paragrafin 6 të Ligjit nr. 04/L-101 për

Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 2, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-116.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Kryesuesja: Në bazë të nenit 89 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-068, Bordi i Komisionit Rregullativ për Prokurimit Publik, përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët emërohen për një mandat pesë vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Kryetari dhe anëtarët e KRPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Qeveria i ka dërguar Kuvendit propozimin për emërimin e kandidatit për kryetar të KRPP-së.

Kandidatët e propozuar duhet të përmbushin kushtet, të përcaktuar me nenin 89, paragrafët 3 dhe 4, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 51 të Ligjit nr.05/L-068, dhe atë të kenë diplomë universitare, së paku 5 vite përvojë në fushën e financave publike dhe në fushën e prokurimit dhe të mos kenë ndonjë ndalesë ligjore që të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të prokurimit publik.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka propozuar kandidatin z. Osman Vishaj, për emërim si kryetarit i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Në bazë të dokumentacionit të bashkangjitur nga Qeveria në propozim-vendimin e dërguar në Kuvend për emërimin e z. Osman Vishaj në cilësinë e kryetarit të KRPP-së, kuptojmë se kandidati i propozuar i plotëson kushtet formale të parapara me nenin 89 paragrafët 3 dhe 4, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 51 të Ligjit nr.05/L-068, ka diplomë univerzitare dhe përvojë punë në fushën e financave publike dhe të prokurimit publik. Si dhe ka bashkangjitur dëshmi nga Gjykata se ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale

Dardan Molliqaj: Theksoi se si PSD dhe unë personalisht do ta mbështesim kandidaturën e z. Osman Vishaj, pasi që e njohë personalisht, dhe i njëjti është i përgaditur profesionalisht dhe ka integritet moral për këtë pozitë.

Arbërie Nagavci: E mora fjalën jo me hap debat, por meqë kolegu Dardani tha që e njoh personalisht, më intereson të dijë a po bëhet fjalë për një person me emër dhe mbiemër të ngjashëm që është akuzuar për vepër penale në një rast të prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë.

Dardan Molliqaj: Theksoi për sa di unë, kandidati në fjalë nuk është i akuzuar dhe i njëjti punon në Ministrinë e Financave që disa vite dhe nuk besoj që ka lidhje me këtë rast.

Kryesuesja: Theksoi se nga CV shihet se punon në Departamentin për Partneritet Publiko Privat në MF. Po ashtu kandidati ka treguar se ka punuar edhe me punë të prokurimit në këtë ministri, ndërsa nuk ka ndonjë shënim se ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë. Po ashtu kandidati e ka dëshminë e gjykatës se ndaj tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale.

Enver Hoti: I kam shqyrtuar dokumentet që janë bashkangjitur propozim vendimit të qeverisë dhe kandidati i plotëson kushtet për këtë pozitë. Pa dashtë me replikue me kolegun, por nuk ka qenë praktikë për me ngrit dilema për kandidatët që i plotësojnë kushtet ligjore për tu emëruar në pozita të caktuara.

Arbërie Nagavci: Theksoi se nuk jam e interesuar me hap debat dhe se diskutimi im nuk ishte për të ngritur tendeca dhe as për të njollosur dikën, vetëm se e ngrita çështjen për sqarim, me qenë se kolegu Dardani tha që e njoh personalisht.

Ali Lajçi: Theksoi se vazhdimisht bëhen debate dhe ka dilema për preferencat për emrat e kandidatëve të propozuar për emërim, edhe pse për këtë rast janë bashkangjitur dëshmitë për përgaditjen profesionale.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, zëvendëskryetarja e parë, konstatoi se komisioni me Shtatë vota Për, Një Kundër dhe Një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit që të emërojë z. Osman Vishaj, për kryetar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Mandati i kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është pesëvjeçar, në pajtim me nenin 89, paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 51 të Ligjit nr.05/L-068.

4. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona

Kryesuesja: Sipas kërkesës së Komisionit, Agjencia, me 18 korrik 2018, ka dërguar një shkresë sqaruese lidhur me historikun e aspektit ligjor të pagesës së komisionerëve të kësaj Agjencie.

Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përcakton se Kuvendi emëron një anëtar të Komisionin për Kërkesa Pronësore (neni 8.2) dhe dy anëtar të Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Kuvendi me datë 30.03.2018 ka emëruar një anëtar të Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Lidhur me pagesën e tyre, në bazë të nenit 8.1 të Ligjit është përcaktuar që Komisioni për Kërkesa Pronësore, aktivizohet sipas nevojës dhe paguhet për sesionet e mbajtura. Ndërsa për Komisionin për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përveç që thuhet se Dy nga anëtarët zgjidhen nga Kuvendi (neni 9), nuk kemi ndonjë dispozitë që rregullon çështjen e kompensimit.

Mbi këtë bazë, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i ka dërguar një shkresë Kuvendit, ku kërkon që të caktohet pagesa për një anëtar të Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar tjerë të Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, të cilët i ka emëruar Kuvendi. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më datë 4.7.2018, pasi që ka shqyrtuar kërkesën e Agjencisë, me qëllim të analizës dhe marrjes së informacioneve shtesë nga Agjencia, ka caktuar një grup punues, i cili nuk ka arritur të mbajë ndonjë takim. Anëtar të Grupit Punues ka qenë Mërgim Lushtaku, ndërsa anëtare Arbërie Nagavci.

Mërgim Lushtaku: Theksoi se grupi punues nuk arritur të mblidhet më herët për shkak të pushimeve verore. Pas kohës së pushimeve e kemi caktuar një mbledhje, por për shkak mos kordinimit të kohës nuk kemi mundur të takohemi. Pastaj, kemi vlerësuar se është mirë kjo çështje mund të vendoset në komision, duke bërë krahasime edhe me agjencitë e ngashme.

Arbërie Nagavci: Theksoi ka qenë në mbledhjen e komisionit kur është diskutuar kjo temë dhe ka qenë e paqartë dhe për mua është e papranueshme që ne si komision apo grup punues të propozojmë paga për personat e caktuar. Mendojë që kjo duhet rregullohet në mënyrë ligjore dhe nuk kam pasur njohuri që janë pjesë e këtij grupi punues dhe nuk jam e gatshme të jemë pjesë e një grupit punues për caktimin e pagave, pa i ditur dhe vendosur pararpakisht edhe kushtet edhe kriteret për pagesën. Meqenë se nuk jam e bindur që kjo është mënyra e caktimit të pagave nuk mundem të jem pjesë e një grupi të tillë punues.

Mërgim Lushtaku: Propozojë që të bëhet një grup punues i ri dhe të ketë së paku tre anëtar.

Kryesuesja konstatoi se në bazë të propozimit, Komisioni unanimisht, caktoi Grupin Punues për shqyrtimin e Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore, dhe dy anëtarë tjerë të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, me këtë përbërje: Mërgim Lushtaku, kryesues, Blerim Kuçi, anëtar, dhe Fikrim Damka, anëtar. Grupi punues e paraqet Raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

5. Të ndryshme

Kryesuesja: Theksoi se në bazë të planit vjetor të punës së komisionit, ne kemi caktuar që të mbikëqyrim dy ligje. Njërin e kemi mbikëqyrur dhe është hartuar raporti me rekomandime është miratuar në Komision dhe për shkak të mospërkthimit të materialit në gjuhën serbe, ende nuk është proceduar për shqyrtim në seancë. Ndërsa, në pjesën e dytë kemi caktuar të mbikëqyrim Ligjin për fondet pensionale të Kosovës. Propozojë që të caktojmë një grup punues, i cili do të bëjë mbikëqyrjen e ligjit dhe të hartojë raportin i cili do të duhej të dal në Kuvend brenda vitit.

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit, konstatoi se Komisioni unanimisht, caktoi Grupin Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116, me këtë përbërje: Blerim Kuçi (kryesues), Naser Osmani, anëtar, Mërgim Lushtaku, anëtar, Ali Lajçi, anëtarë, Enver Hoti, anëtar dhe Fikrim Damka, anëtar. Grupi Punues përgadit raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 13:25.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit,

Safete Hadërgjonaj